

Sinjalizime

Ekskluzive | Kontrolli policor në Obiliq zbulon pistoletë me numër serik të fshirë, 36-vjeçari përfundon në ndalim



Sinjali.com

09 Korrik 2026 08:49



Një kontroll rutinë i Policisë në territorin e Obiliqit ka çuar në sekuestrimin e një arme zjarri me numër serik të fshirë dhe arrestimin e një 36-vjeçari, raporton Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se rasti ka ndodhur mbrëmjen e 8 korrikut, rreth orës 20:30, gjatë një pike kontrolli të organizuar nga Policia në fshatin Kryeshec, ku është ndaluar për kontroll një veturë Volkswagen Caddy me ngjyrë të kuqe.

Gjatë kontrollit të automjetit, zyrtarët policorë kanë gjetur dhe sekuestruar një pistoletë të tipit “Zoraki”, kalibër 7.65 mm, me numër serik të fshirë, një karikator dhe pesë fishekë.

Sipas burimeve, arma dyshohet se mbahej pa autorizim, ndërsa drejtuesi i automjetit, Alban Neziri rreth 36-vjeç, nuk ka poseduar leje për mbajtjen apo posedimin e saj.

I dyshuari është shoqëruar në stacion policor, ku është intervistuar në prani të avokatit mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare.

Me autorizim të Prokurorit kujdestar është iniciuar rasti për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, ndërsa me vendim të Prokurorit, 36-vjeçari është dërguar në Qendrën e Ndalimit për 48 orë.

Rasti po hetohet nga organet kompetente.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Obiliq

ndalim

kontroll

pistoletë

Të tjera:




Ekskluzive | Nga mashtrim në vjedhje: Policia zbardh rastin vjedhjes së 190 eurove...

Ekskluzive




Tragjike: Dy të vdekur në Obiliq pas aksidentit ku motoçikleta goditi këmbësin...

Siguri




Ekskluzive | Ky është i dyshuari në rastin e ambulancës ilegale në Obiliq – dyshohet se...

Ekskluzive



Zbulohet ambulancë ilegale brenda një objekti të braktisur në Obiliq, intervistohen d...

Siguri



Ekskluzive | Armë me 5 fishekë nën ulësen e BMW-së – 26-vjeçari ndalohet nga Policia n...

Ekskluzive



Ekskluzive: Zbulohet kush janë të rinjtë që dyshohet se e rrahën me zinxhirë hekuri 19-...

Siguri



Ajri i ndotur gjatë dimrit, këto janë problemet shëndetësore që mund të shkaktojë

Kosovë



Ky është personi i cili u gjet i vdekur në Obiliq afër shtëpisë së tij

Sociale

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Applikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera